

## ZHVILLIMET ETNOLITIKE NË KOSOVË PËRMES HISTORISË

Edi SHUKRIU<sup>1</sup>

### Rezyme

Proceset etnolitike në Kosovë kanë kaluar nëpër faza të llojshme, që nga epoka e neolitit deri në mesjetë. Banorët më të hershëm të saj ishin dardanët/ilirët, ndërsa pushtimet dhe migrimet e zhvilluara gjatë ecejakeve historike e bënë të bujshme dhe me luftëra historinë e saj, dhe, njëkohësisht, e bënë më të larmishme strukturën e saj etnike. Manipulimet me strukturën etnike dhe historinë e Kosovës shkaktuan edhe konflikte të armatosura. Përkundër kësaj, baza etnolitike e Kosovës dhe diversiteti i krijuar kulturor e etnik duhet parë si pasuri të saj dhe duhet shfrytëzuar për njohje, mirëkuptim dhe respektim të ndërsjellë.

**Fjalët kyçe:** Proceset etnolitike, dardanët, fiset indoeuropiane, shteti dardan, kisha ortodokse serbe.

Proceset etnolitike në Kosovë kanë kaluar nëpër faza si edhe te disa popuj të tjerë të Europës Juglindore, por këto nuk u panë si të tilla nga disa studiues nacionalist të formimit të popujve dhe të historisë reale. Manipulimet me strukturën etnike dhe historinë e Kosovës shkaktuan edhe konflikte të armatosura dhe, si rrjedhim, ngarkesa etnopsikologjike. Në kuadër të kësaj, relacionet shekullore dhe komplekse shqiptaro - serbe u bënë njëra prej relacioneve më të ndjeshme të historisë së Ballkanit, të cilat ende kanë refleksione në aktualitet.

Ndonëse parimi historik për përcaktimin ndërkombëtar të të drejtës për subjektivitet është bërë anakronik, mitizimi i vazhdueshëm i Kosovës dhe propaganda për të drejtën për të e shtrojnë edhe sot nevojën që historia e Kosovës të vihet në pah.

Është e njohur se në Kosovë, të zhveshur nga mitet dhe mitizimi i saj, banorët më të hershëm ishin dardanët, njeri nga fiset më të mëdha ilire. Dardanët ishin gërshetim i substratit neolitik dhe adstratit eneolitik të fiseve indoeuropiane, ndërsa kultura materiale e shpirtërore e epokës së bronzit dhe të hekurit bën pjesë në kompleksin ilir. Proceset integruese etnolitike të epokës së hekurit bënë që

---

<sup>1</sup> Profesor Ordinar Universiteti I Prishtinës

---

---

dardanët të jenë prezent si një popullatë me territor të njohur dhe kulturë të formuar. Ndonëse burimet e shkruara i përmendin dardanët e Ballkanit nga shekulli IV p.e.r., kultura paraprake e zbuluar në Kosovë dëshmon mbi kontinuitetin e banimit dardan në to deri në mesjetën e hershme<sup>2</sup> dhe më tej.

Dardanët hynë në antikë në shek. IV p.e.r. dhe jo me pushtimet e perandorisë romake (shek I p.e.r.), si përfundohej më parë.<sup>3</sup> Sipas studimeve të decenieve të fundit dardanët hynë në antikë me krijimin e shtetit të Dardanisë, falë zhvillimit të brendshëm të shoqërisë dardane dhe lidhjeve të dëshmuara intenzive me botën e Mesdheut gjatë fazës protourbane dardane (VI-IV p.e.r.), që kishin si rrjedhim diferencimin e thelluar shoqëror dhe dukjen e qendrave urbane.<sup>4</sup>

Dardania u pa deri vonë nga disa studiues vetëm si një subjekt mbifisnor, i cili nuk arriti shkallën e formësimit shtetëror,<sup>5</sup> gjë që ishte pasojë e mos njohjes së materialit relevant arkeologjik të Kosovës, si territor qendror i shtrirjes dardane, e paragjykimeve mbi retardimin dardan dhe e paragjykime me baza politike. Zhvillimi protourban dardan e mohon këtë qëndrim, si dhe ekzistimi i shtetit dardan, i cili dëshmohet nga territori kompakt i Dardanisë, institucioni i mbretit (Longari, Bato, Monuni), froni i trashëguar (Longari dhe djali i tij Bato), institucioni i skllavërisë (dulët/duloit dhe robërit e luftës), ushtria e organizuar (fallanga prej 8.000 vetash), veprimtaria diplomatike (aleanca me shtetin ilir, etolët, medët, skordiskët, perandorinë romake etj.), si dhe me martesat dinastike (martesa e princeshës dardane, Etutës, me mbretin ilir Gencin).

Territori i Mbretërisë Dardane përfshinte Kosovën e sotme, Serbinë juglindore, Maqedoninë veriperëndimore dhe një pjesë të Sanxhakut. Në të u zhvilluan qendrat urbane, të cilat përmenden nga shkrimtarët antik si *polis arhaia* tek Straboni<sup>6</sup> apo *urba* tek Livi.<sup>7</sup> Shteti dardan ishte forca e vetme e madhe politike në Ballkanin qendror nga shekulli IV p.e.r. deri në kohën e pushtimeve romake.<sup>8</sup> Në të u përfshi edhe Peonia, që u bë një prej shkaqeve kryesore të konflikteve të vazhdueshme me shtetin e Maqedonisë, për ç'gjë dardanët u quajtën në burime antike si *gens*

---

<sup>2</sup>Edi Shukriu (2004) *Ancient Kosova*, Museum of Kosova, Prishtina; Fanula Papazoglu (1989) "Dardanska i Ilirska kraljevina", *Iliri i Albanci*, Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Beograd, 169.

<sup>3</sup> Edi Shukriu (1996) *Dardania paraurbane*, Dukagjini, Pejë.

<sup>4</sup> Edi Shukriu (2004).

<sup>5</sup> Fanula Papazoglu (1969) *Srednjbalkanska plemena u predrimsko doba*, Sarajevo, 111.

<sup>6</sup> Strabonis, *Geographica* VII 1, 5.

<sup>7</sup> Livius, *Ab urbe condita* XIV 4, 7-10; XXVI 25, 3.

<sup>8</sup> Fanula Papazoglu (1969), 337.

---

*semper infestissima Macedoniae.*<sup>9</sup> Dardanët i rezistuan vërshimeve kelte, iu shmangën planeve maqedone e bastarne për shkatërrimin e tyre dhe i rezistuan ushtarakisht pushtimeve romake deri në mesin e shekullit I, kur Dardania u pushtua tërësisht nga perandoria romake.

Mëvetësia 400 vjeçare, zhvillimi ekonomik, shoqëror dhe kulturor dardan krijuan entitetin dhe vetëdijen etnike që u ruajt edhe pas sundimit romak dhe atij bizantin. Në panteonin dardan mbijetuan hyjnitë e hershëm si Dea Dardane dhe hyu Andin,<sup>10</sup> si dhe hyjtë e tjerë ilirë, u ringjallë tradita parahistorike e varrimit në tuma gjatë periudhës romake, u ruajt tradita e veshjes autoktone, si dëshmojnë monumentet epigrafike, dhe mbijetuan emrat dardanë/ilirë, ashtu si mbijetoi dhe emri i dardanëve dhe i Dardanisë deri në mesjetë.<sup>11</sup>

Falë etnitetit të krijuar, Dardania qëndroi si tërësi më vete në kuadër të provincës romake Moesia Superior, për t'u bërë më pas Provincë e Dardanisë në kohën e perandorit Aurelian (271), duke ngel e tillë edhe pas reformave të perandorit Dioklecian (279), si pjesë e dioqezës së Ilirikut e deri te reformat e Justinianit, në shekullin VI. Fakti se në Dardani kishte më së shumti stacione beneficiare me ushtarë beneficiarë (polici territoriale),<sup>12</sup> është dëshmi e rezistencës dardane ndaj pushtimit romak dhe ndaj romanizimit në tërësi. Kjo rezistencë shprehet edhe përmes kryengritësve dardan, të njohur nga burimet antike me emrin *latrones dardanici*.<sup>13</sup>

Me ndarjen e perandorisë romake, në atë Perëndimore e Lindore (395), Dardania u bë territor kufitar në mes dy perandorive dhe dy botërave në krijim e sipër, po aq sa dhe lidhje midis tyre. Në vitin 437 Dardania iu bashkëngjitë Perandorisë Lindore.

Integrimet etnolitike ilire nuk u ndërprejnë me pushtimet romake. Përkundrazi, proceset integruese u intensifikuan pas përfshirjes së të gjitha trojeve ilire nën ambrellën e një perandorie, duke krijuar në këtë mënyre bazë për formimin mesjetar të arbërve-shqiptarëve, pasardhësve të ilirëve.

---

<sup>9</sup> Idem, 111.

<sup>10</sup> Edi Shukriu (1989) "Dea e Dardanisë dhe mozaiku i Orfeut", Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 14, Prishtinë, 15-19.

<sup>11</sup> Fanula Papazoglu (1989), 169.

<sup>12</sup> Idem, 156.

<sup>13</sup> Emil Cerschkov (1969) Rimljani na Kosovu i Metohiji, Beograd, 54.

---

---

---

Depërtimi dhe vendosja e sllavëve në Ballkan, për ndryshim nga lëvizjet transitore të fiseve dhe të popujve të tjerë, ndryshoi rrjedhat historike të Ballkanit. Vendosja e tyre u zhvillua për një periudhë më të gjatë, me një intensitet më të vogël në drejtim të jugut, përmes, si shkruan P. Lemerle: *...depërtimit të mëvetëshëm të fiseve të veçanta sllave, depërtimit në përbërjen e "ushtrive" masovike etnike nën udhëheqjen e avarëve, vendosjes paqësore të bashkësive më të vogla.*<sup>14</sup>

Në territorin e Kosovës, si dhe në viset e tjera arbërore - shqiptare depërtuan më pak valët avaro-sllave të shekujve VI-VII. Këto valë shkonin kryesisht nga rrethi i Singidunum-it (sot: Beogradi) në drejtim të brigjeve të Detit të Zi, të Trakisë dhe të Konstantinopojës.<sup>15</sup> Në Dardani, Prevalitanë, Epir të Ri e Epir të Vjetër, sipas burimeve bizantine, nuk evidentohet asnjë territor i pushtuar nga sllavët (skllavini) në mesin e shekullit VII, përderisa ato ekzistonin në Thraki, Maqedoni e deri në Peleponez.<sup>16</sup> Ndonëse burimet e shkruara për periudhën përkatëse janë të mangëta, të dhënat e sipërpërmendura si dhe dëshmitë arkeologjike flasin mbi strukturën e pandryshuar etnike të Kosovës dhe të viseve të tjera iliro-arbërore në këtë periudhë. Këtë e dëshmon edhe materiali toponomastik, tek i cili gjenden pak toponime sllave të valëve të para migratore sllave në territoret ku jetonin arbërit-shqiptarët.<sup>17</sup>

Depërtimi serb në Kosovë dhe më në jug, si pohon K. Jireček, nisi tek nga fundi i shekullit XI.<sup>18</sup> Ndërkohë, popullata autoktone vazhdoi të jetojë në vendbanimet e fortifikuara, të ngritura me teknikën identike të ndërtimit dhe me kulturë materiale si në ato të trojeve të tjera arbërore, tani nën ndikimin e fuqishëm të kulturës bizantine. Kishat e shumta të Kosovës vërtetojnë të dhënat e burimeve të shkruara të kohës mbi besimin e krishterë të arbërve të Kosovës. Këtë e vërtetojnë edhe toponimet që ndeshen në Kosovë, në trajtën burimore të tyre, si *Kisha e Vjetër, Kisha e kalasë, Arat e kishës, Varret e kishës* etj.

Nga fundi i mijëvjeçarit të I-rë Kosova u përfshi në shtetin e mbretit bullgar Samuilin (976-1014), ku bënin pjesë Bullgaria, Maqedonia, Thesalia, Epiri,

---

<sup>14</sup> Frano Barisic (1969) "Proces slovenske kolonizacije istocnog Balkana", Predslovenski etnicki elementi na Balkanu u etnogenezi juznih slovena, Sarajevo, 11.

<sup>15</sup> Pierre Lemerle (1954) "Invasions et migrations dans les Balkans depuis la fin de l'epoque Romaine jusq'au VIIIe siecle", Revue Historique 78, Paris, 294.

<sup>16</sup> Miraculla Sancti Demetrii, Lib.2 I, 158.

<sup>17</sup> Jorgji Gjinari (1988) "Dëshmi për historinë e gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar", Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij, Tiranë, 215-223, harta 1.

<sup>18</sup> Konstantin Jirecek - Jovan Radonic (1952) Istorija Srba I, Beograd, 124, 137, 152, 157.

---

---

Shqipëria, Dukla, Travunja, Zahumlja, Rashka, Sremi e Bosna<sup>19</sup>, për të rënë përsëri nën pushtetin bizantin deri në kohën e pushtimit nga shteti mesjetar serb (1275).<sup>20</sup> Periudha e pushtimit të Kosovës nga shteti mesjetar serb prej 1275-1455, pas të cilit nis sundimi osman, paraqet një prej periudhave më të rënda të historisë së popullatës autoktone arbërore dhe të përsiatjeve të saj për ruajtjen e identitetit. Kjo u bë aq më vështirë për shkak se ilirët, si shkruan K. Jirecek: *...duken në mesjetë si popull i vjetër i krishterë me kulturë më të lartë urbane, e cila është shumë më e afërt grekëve dhe romanëve dalmatin se sa serbëve të posa pagëzuar.*<sup>21</sup> Këtij pohimi duhet shtuar edhe faktin se banorët ilirë-arbëror ishin kryesisht bartës të krishterimit edhe gjatë shekujve XI-XII.

Mbështetja arbërore në Kishën Perëndimore, pas ndarjes së kishave, dhe përkatësia lindore e kishës orthodoxe serbe kishin si pasojë asimilimin sllav të një pjese të arbërve orthodox dhe ndëshkimin e popullatës jo sllave. Sipas burimeve, mbreti serb Stefan Dushani ishte *mjaft jo tolerant ndaj katolikëve dhe nuk e duronte katolicizmin në masa.*<sup>22</sup> Madje edhe Papa Klementi VI reagoi në vitin 1347 te mbreti i Rashkës, Stefan Dushani, lidhur me uzurpimin e kishave katolike në Prizren, Novo Bërdë, Trepçë, Janjevë dhe në vende të tjera.<sup>23</sup> Po ashtu, Papa Inocenti VI, kur e pranoi delegacionin e mbretit serb Stefan Dushanit, i cili kishte shkuar për të kërkuar pajtim me Kishën romake, ua përkujtoi premtimet e mbretit Dushan se asnjë person laik apo kishtar nuk do të guxonte t'i pagëzonte latinët apo besimtarët e tjerë.

Politikën fetare, të mpleksur me motive etnike, kulturore dhe politike, Stefan Dushani e fiksoi në Kodin e vitit 1349, ku përcaktohen masat e rrepta ndëshkuese për grupet që nuk pranojnë të konvertohen. Në këtë kod, pos tjerash, shkruan: *Lidhur me herezinë latine... në qoftë se ndokush nuk dëgjon të konvertohet e të kthehet në besimin e vërtetë, ai do të dënohet me vdekje... Klerikët heretikë të një komunioni të huaj që përpiqen të bëjnë proselitë, do të kapen, do të dërgohen në miniera ose do të dëbohen. Kishat heretike do të konsakrohen e do t'u besohen klerikëve të besimit të vërtetë...në rast se nuk dëgjon të pagëzohet, atij do t'i hiqen*

<sup>19</sup> Enciklopedia Leksigografskog Zavoda 5 (1969) Zagreb, 599.

<sup>20</sup> Historija Naroda Jugoslavije I (1953) Zagreb, 412.

<sup>21</sup> Konstantin Jirecek - Jovan Radonic (1952), 86.

<sup>22</sup> Miodrag Purkovic (1934) Avinjonske pape i srpske zemlje, Pozarevac, 49.

<sup>23</sup> Gasper Gjini (1986) Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća, Zagreb, 100.

---

---

*gruaja, fëmijët e shtëpia, do të katandiset në mjerim e do të detyrohet të emigrojë...*<sup>24</sup>

Nga teksti i sipërshtënuar kuptohet se në shekujt XII-XIV besimi katolik (*Arbanaska vera*, si e quanin serbët - *feja shqiptare*)<sup>25</sup> ishte i përhapur në Kosovë dhe se presionet e shtetit mesjetar serb dhe të kishës orthodoxe serbe kanë qenë të përhershme. Synimi ishte asimilimi etnokulturor dhe fetar i shqiptarëve, pasi që këta bartnin elemente dalluese dhe autoktone në shtetin mesjetar serb.<sup>26</sup> Duket se kjo është faza kur një pjesë e popullatës u serbizua, gjithnjë duke e parë edhe në kontekstin e lidhshmërisë shpirtërore me kishën dhe me nivelin e ultë arsimor të popullatës në këtë kohë.

Koha e sundimit të shtetit mesjetar serb ishte përgjithësisht kohë e identifikimit të përkatësisë orthodoxe me përkatësinë etnike serbe dhe kohë e presionit të shtetit mesjetar serb dhe e kishës orthodoxe serbe ndaj popullatës joslave, përgjithësisht arbërore-shqiptare. Andaj, për t'u realizuar konvertimi, peshkopët ortodoks grek u zëvendësuan me peshkopë serb. Po ashtu u përvetësuan objektet sakrale, që ishin kryesisht në shërbim të popullatës autoktone arbërore. Rast i tillë është Kisha Shën Premtes në Prizren, e cila u ngrit mbi tempullin e periudhës romake dhe të bazilikave të shekujve V-VI, XI e XIII,<sup>27</sup> ndërsa që në vitin 1019 aty gjendej qendra e peshkopatës së Prizrenit.<sup>28</sup> Pas rindërtimit nga ana e mbretit serb Millutin (1307) kisha u përvetësua dhe iu ripërkushtua "Të ngriturit të Zonjës në Qiell". Përkundër kësaj, banorët e sotëm vazhdojnë ta quajnë Kisha e Shën Premtes, ashtu si e quajnë dhe banorët serb në përkthim nga emërtimi burimor arbëror (serb. Sveta Petka).<sup>29</sup>

Stili i hipnozës së përsëritur mbi pronësinë serbe mbi kishat dhe mbi tezën se shqiptarët erdhën në Kosovë tek në shekujt XVII-XVIII,<sup>30</sup> u shfrytëzuan në mëtimet për ndarjen e Kosovës nga trangu ilir-arbëror-shqiptar në nismë të shekulli XX dhe,

---

<sup>24</sup> Stojan Novakovic (1898) *Zakonik cara Stefana Dusana*, Beograd, 153-154.

<sup>25</sup> Pietro Bogdano (1685) *Cuneus Prophetarum*, pars prima. Patavii -Introduc.

<sup>26</sup> Pëllumb Xhufi (1990) "Heretikë shqiptarë në mbretërinë mesjetare serbe", E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 103.

<sup>27</sup> Slobodan Nenadovic (1963) *Bogorodica Ljevicka*, Beograd; Edi Shukriu (1993) "Kisha e Shën Premtes në Prizren", *Buletin i Fakultetit Filozofik XXI*, Prishtinë, 89-100.

<sup>28</sup> Slobodan Nenadovic (1963), 23; Gasper Gjini (1986), 87.

<sup>29</sup> Edi Shukriu (1993), 97, 99.

<sup>30</sup> Jovan Cvijić, *Balkansko poluostrvo*, Beograd 1966, 339; A. Urošević, *Kosovo, Naselja i poreklo stanovništva* 39, Beograd 1965, 21; M. Filipović (1937) "Etnicke prilike Juzne Srbije", *Spomenica 25 godisnjice oslobadjanja Juzne Srbije*, Skopje, 687.

mjerisht, vazhdon nga disa edhe në fillim të shekullit XXI. Këtyre tezave që herët iu kundërvu Konstantin Jirecek, autor i historisë voluminoze serbe, i cili shkruan: *Është i gabuar mendimi, i cili përndryshe ndeshet shpesh në kohën tonë, se elementi arbanas ka depërtuar tek në kohën turke në lindje.*<sup>31</sup> Në mbështetje të prezencës shqiptare në Kosovë flasin dhe vet burimet serbe. Në kartat (krisobulat) e mbretërve serb, të Stefan Dushanit dhe të Stefan Deçanit, pos antroponimeve tipike shqiptare Gjin, Lesh, Dedë, Tanush apo Barda, paraqiten edhe emra të pazakontë për sllavët si Dhimitër, Andrea, Aleks apo Domenik.<sup>32</sup> Në kartat e mbretërve mesjetar serb shumë emra shqiptarë kanë marrë sufiksin sllav -iq, si është rasti me emrat Vogliq (shqip: i vogël), Kuqeviq (shqip: i kuq), Gjon-oviq, Tishan-oviq apo Flokovci (shqip: flokë).<sup>33</sup> Po ashtu janë raste të shpeshta kur Pribislavi apo Dobrosllavi dalin si bij apo vëllezër të Gjinit, Bushatit ose Leshit.<sup>34</sup>

Nënshkrimi i marrëveshjes së Patrikanës së Konstantinopolit me Portën e Lartë (1453) nënkuptoi edhe veprim të mëtejshëm të lirë të Kishës serbe ndaj popullatës jo sllave. Të gjendur midis Scilës dhe Haribdës mesjetare, të presionit shtetëror otoman, atij islam dhe orthodoks serb, shqiptarët u gjendën para dy zgjedhjeve jetike: të ndërrimit të fesë në favor të ruajtjes së identitetit kombëtar shqiptar apo të serbizimit nën presionin e kishës serbe, e cila përkatësinë orthodokse e identifikonte me përkatësinë etnike. Një pjesë e shqiptarëve e bëri zgjedhjen e parë, duke u konvertuar në islamizëm.

Prezencën shqiptare në Kosovë gjatë mesjetës e vërtetojnë edhe të dhënat mbi strukturën etnike të qytetit Prizren. Në vitin 1591 qyteti kishte 56% shtëpi muslimane (shqiptare) dhe 44% shtëpi të krishtera, ndërsa nga raporti i Pjetër Mazrekut kuptojmë se në vitin 1623 kishte 12.000 muslimanë, 200 katolik shqiptarë dhe 600 serb.<sup>35</sup> Në vitin 1624, sipas raportit të Kryepeshkopit Gjergj Bardhi, Prizreni kishte 3.500 shtëpi muslimane, 80 orthodokse dhe 40 katolike.<sup>36</sup> Në vitin 1875 konzulli rus në Sarajevë, A. Gilferding, shkruan se shumica e familjeve muslimane në Prizren (3.000) dhe të gjitha familjet katolike (100) janë

<sup>31</sup> Konstantin Jirecek (1962) "Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjeg veka", Zbornik K. Jireceka II, Beograd, 49-50.

<sup>32</sup> Pëllumb Xhufi (1990), 104 dhe literatura.

<sup>33</sup> R. Grujic (1934) "Licna vlastelinstva srpskih crkvenih predpostavnika u XIV i XV veku", Glasnik Srpskog Naucnog Drustva, Skoplje, 63.

<sup>34</sup> Muhamet Tërnavë (1974) "Shqiptarët në feudin e Deçanit", Buletin i Fakultetit Filozofik, Prishtinë, 255-271; Pëllumb Xhufi (1990), 104.

<sup>35</sup> Kosova, dikur dhe sot, Prishtinë 1969, 923.

<sup>36</sup> Jovan Radonic (1950) Rimska kurija u juznoslovenske zemlje od XV-XIX veka, SANU, Beograd, 107.

---

---

shqiptarë, ndërsa në familjet orthodoxe (900) bëjnë pjesë serbët, cincarët, bullgarët dhe grekët. Branislav Nushiç pohon se në gjysmën e dytë të shekulli XIX Prizreni nuk kishte më shumë se 10 deri në 15 familje turke, duke thënë: *...mjerisht, për kah madhësia Prizreni është qytet shqiptar e ata e konsiderojnë sili të tyre.*<sup>37</sup> Përqindja e tillë e popullatës shqiptare në Prizren në periudhat e ndryshme të mesjetës, e lejon mundësinë e konstatimit se në pjesët e tjera të Kosovës përqindja e strukturës etnike shqiptare ishte po aq e madhe, mos më shumë.

Represioni i sërishëm ndaj popullatës shqiptare në Kosovë pas vitit 1912, me qëllim të ndryshimit të strukturës etnike, edhe pse krijoi disa valë migrimesh të dhunshme, kryesisht në drejtim të Turqisë, nuk e ndryshoi këtë strukturë në disfavor të shqiptarëve. Kjo nuk u arrit as me planet famëkeqe andriqiane, qubriloviqiane e të tjerëve, për spastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët.<sup>38</sup> Nuk u arrit as me planet milosheviqiane dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë të fundit të shekullit XX, falë rezistencës së popullit të Kosovës për liri, pavarësi dhe demokraci dhe intervenimit të NATO-s.

E kaluara e Kosovës sot duhet konsideruar si begati e saj. Baza etnolitike dhe diversiteti kulturor, etnik dhe fetar, i krijuar gjatë ecejakeve historike duhet shfrytëzuar në tumirë të njohjes, mirëkuptimit dhe respektimit të ndërsjellë.

Prishtinë, 29 mars 2009

#### **Literatura dhe burimet**

Andric, Ivo (1977) *Elaborat o Albaniji, Časopis za Suvremenu Povijest*, Zagreb.

Barisic, Frano (1969) "Proces slovenske kolonizacije istočnog Balkana", *Predslovenski etnički elementi na Balkanu u etnogenezi južnih slovena*, Sarajevo.

Bogdano, Pietro (1685) *Cuneus Prophetarum, pars prima. Patavii -Introduc.*

Cershkov, Emil (1969) *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, Beograd.

Cubrilovic, Vasa (1937) *Isterivanje Albanaca, Memorandum*, Beograd

Enciklopedia Leksikografskog Zavoda 5 (1969) Zagreb.

---

<sup>37</sup> Branislav Nusic (1936) *Razni spisi*, Beograd, 259-260.

<sup>38</sup> Vasa Cubrilovic (1937) *Isterivanje Albanaca, Memorandum*, Beograd; Ivo Andic (1977), *Elaborat o Albaniji, Časopis za Suvremenu Povijest*, Zagreb.



- 
- 
- Filipovic, Milorad (1937) "Etnicke prilike Juzne Srbije", Spomenica 25 godisnjice oslobadjanja Juzne Srbije, Skopje.
- Gjinari, Jorgji (1988) "Dëshmi për historinë e gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar", Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij, Tiranë.
- Gjini, Gasper (1986) Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća, Zagreb.
- Historija Naroda Jugosllavije I (1953) Zagreb.
- Grujiq, R. (1934) "Licna vlastelinstva srpskih crkvenih predpostavnika u XIV i XV veku", Glasnik Srpskog Naucnog Drustva, Skoplje.
- Jirecek, Konstantin – Radonic, Jovan (1952) Istorija Srba I, Beograd.
- Jovan Cvijić, (1965) Balkansko poluostrvo, Beograd 1966.
- Jirecek, Konstantin (1962) "Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjeg veka", Zbornik K. Jireceka II, Beograd.
- Kosova, dikur dhe sot (monografi), Prishtinë 1969.
- Lemerle, Pierre (1954) "Invasions et migrations dans les Balkans depuis la fin de l'epoque Romaine jusq'au VIIIe siecle", Revue Historique 78, Paris.
- Nenadovic, Slobodan (1963) Bogorodica Ljevska, Beograd; Edi Shukriu (1993) "Kisha e Shën Premtes në Prizren", Buletin i Fakultetit Filozofik XXI, Prishtinë.
- Novaković, Stojan (1898) Zakonik cara Stefana Dusana, Beograd.
- Nusic, Branislav (1936) Razni spisi, Beograd.
- Papazoglu, Fanula (1989) "Dardanska Ilirska kraljevina", Iliri i Albanci, Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Beograd.
- Papazoglu, Fanula (1969) Srednjebalkanska plemena u predrimsko doba, Sarajevo.
- Purkovic, Miodrag (1934) Avinjonske pape i srpske zemlje, Pozarevac.
- Radonic, Jovan (1950) Rimska kurija u juznoslovenske zemlje od XV-XIX veka, SANU, Beograd.
- Shukriu, Edi (2004) Ancient Kosova, Museum of Kosova, Prishtina.
- Shukriu, Edi (1996) Dardania paraurbane, Dukagjini, Pejë.
- Shukriu, Edi (1989) "Dea e Dardanisë dhe mozaiku i Orfeut", Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 14, Prishtinë.
- 
-

Edi Shukriu

---

---

Tërnavë, Muhamet (1974) "Shqiptarët në feudin e Deçanit", Buletin i Fakultetit  
Filozofik, Prishtinë.

Urosevic, A. Kosovo, Naselja i poreklo stanovnistva, Beograd.

Xhufi, Pëllumb (1990) "Heretikë shqiptarë në mbretërinë mesjetare serbe", E vërteta  
mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë.

Livius, Ab urbe condita.

Miracula Sancti Demetrii.

Srabanis, Geographica.